



MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM – (MpB)

në mes të

**Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës me regjistrim
Nr: 5200122-6 –në tekstin e mëtejme i referuar si “IADK”**

dhe

Komunës së Vushtrrisë në tekstin e mëtejme referuar si “Komuna”

I. Lënda e MpB

“IADK”-ja dhe “Komuna e Vushtrrisë” pajtohen të rregullojnë një bashkëpunim të afërt me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së projekteve bujqësore të realizuara nga “IADK”-ja në Komunën e Vushtrrisë.

Kjo MpB ka qëllimin të përshkruajë bashkëpunimin në mes të “IADK”-se dhe “Komunës së Vushtrrisë” gjatë periudhës 2019-2020, bazuar në implementimi e projektit **“Trajnimi profesional dhe mundësitë për gjenerimin e të ardhurave në bujqësi për gratë dhe të rinjtë që jetojnë në zonat rurale të Kosovës”** financuar nga CFD dhe implementuar nga IADK, ndërsa projekti do të ketë shtrirje në Komunën e Lipjanit, Shtimes, Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Zubin Potokut.

Palët e lart cekura pajtohen që MpB-ja të përmbajë këto obligime dhe përgjegjësi:

II. Obligimet e IADK-së në implementimin e projektit në Komunën e Vushtrrisë

- IADK do të organizoi një sesion informues përmes të cilit pjesëmarrësit do të njoftohen lidhur me qëllimin e projektit, aktivitetet e projektit, si dhe mënyrën se si mund të përfshihen në projekt;
- IADK do të organizoi trajnime në grupe prej 12 pjesëmarrësve për trajnime në kultivimin e perimeve;
- Të ofrojë tetë (8) trajnime në kultivimin e perimeve, 6 seanca do të jenë trajnime profesionale, ndërsa 2 seanca do të jenë trajnime në aspektin ekonomik;

- Përkrahja me serra me sipërfaqe prej 100 m², për kandidatët më të suksesshëm të cilët plotësojnë kriteret e selektimit;
- IADK do të organizoi trajnime në grupe prej 12 pjesëmarrësve në përpunimin e pemëve dhe perimeve;
- Të ofrojë tetë (8) trajnime në përpunimin e pemëve dhe perimeve, 6 seanca do të jenë trajnime profesionale, ndërsa 2 seanca do të trajnime në aspektin ekonomik;
- Përkrahja me njësi për përpunimin e pemëve dhe perimeve, për kandidaten më të suksesshme e cila plotëson kriteret e selektimit;
- IADK do të organizoi vizita 1-ditore në Kosovë, për të gjithë kandidatët që kanë përcjellë trajnimet sipas moduleve;
- IADK në bashkëpunim me përfaqësuesit nga Komuna e Vushtrrisë do të bëjë përzgjedhjen e përfituesve të serrave dhe njësisë për përpunimin e pemëve dhe perimeve;
- IADK do të furnizojë me pajisje të nevojshme përfituesit e projektit;
- IADK do të monitorojë dhe mbikëqyrë aktivitetin e “Përfituesve”;
- IADK do të organizojë këshilla dhe trajnime për përfituesit për të përgatitur dhe menaxhuar sa më mirë punët rreth serrave dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve;
- IADK-ja do të punojnë ngushtë me Drejtorinë Ekonomi, bujqësi dhe zhvillim rural të Komunës së Vushtrrisë në monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të përfituesve;
- IADK do të organizojë tryeza të rrumbullakëta në temat: 1.Fuqizimi i grave rurale nëpërmjet punësimit dhe trajnimeve profesionale dhe 2.Pjesëmarrja aktive e grave në vendimmarrje në nivel lokal, ku do të marrin pjesë të gjitha palët e interesit siç janë: gratë prodhuese, përfaqësues të institucioneve, donator të ndryshëm.
- IADK do të angazhojë student për praktik në punë me pagesë. Numri i tyre varet nga interesimi dhe plotësimi i kriterëve.

III. Obligimet e “Komunës së Vushtrrisë” në përkrahjen e implementimit të projektit

- “Komuna e Vushtrrisë” dhe “IADK”-ja pajtohen që të përkrahin njëra-tjetrën në zbatimin e projektit në interes të “Komunës së Vushtrrisë” dhe “IADK”-së dhe të cilat zbatohen në “Komunën e Vushtrrisë”;
- “Komuna e Vushtrrisë” do të përkrahë “IADK”-në në bashkëfinancimin e projektit;
- “Komuna e Vushtrrisë” do të bashkëfinancojë projektin të përfituesit të serrave me 20 % dhe të njësisë për përpunimin e pemëve dhe perimeve me 20 % të investimit (shih aneksin I);
- “Komuna e Vushtrrisë” së bashku me “IADK” do të organizojë sesionet informuese, duke informuar shoqatat fermerëve dhe grave të regjistruara në databazën e komunës;
- “Komuna e Vushtrrisë” do t’i ndihmojë “IADK”-së në organizimin e grupeve për trajnimet për kultivimin e perimeve dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve;
- “Komuna e Vushtrrisë” do të ndihmojë në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të serrave dhe njësisë për përpunimin e pemëve dhe perimeve;

- “Komuna e Vushtrrisë” do të monitorojë dhe mbikëqyrë aktivitetet e “Përfituesëve” edhe pas përfundimit të projektit.
- “Komuna e Vushtrrisë” do të asistojë IADK-në në organizimin e tryezave të rumbullakëta dhe caktojë personin, i cili do jetë pjesë e panelit si përfaqësues i Komunës së Vushtrrisë.

Përgjegjësit të tjera

- “IADK” do të shfrytëzojë zyrën dhe sallat për nevoja të projektit në “Komunën e Vushtrrisë” dhe do ta informojë me kohë personin përgjegjës për të gjitha aktivitetet që do të organizohen;
- “IADK” do të njoftoj në mënyrë të rregullt dhe do të raportoj në fund të projektit tek “Komuna e Vushtrrisë” për rezultatet e arritura nga aktivitetet e realizuara në kudër të MpB;

VI Personat Kontaktues

“IADK”-ja dhe “Komuna e Vushtrrisë” do të emërojnë nga një përfaqësues që të rregullojnë kontaktet më të lehta dhe të drejtpërdrejta në mes dy partnerëve. Këta persona do të përfshiheshin drejt për së drejti në implementimin e qetë dhe kohor të kësaj MpB. “IADK” do të përfaqësohet nga Znj. Hafize Veseli ndërsa “Komuna e Vushtrrisë” do të përfaqësohet nga Rabije Zahiti, Udhëheqëse e sektorit për bujqësi në DEBPZHR.

VII Hyrja në fuqi dhe ndërprerja

Kjo MpB hynë në fuqi nga data e nënshkrimit dhe do të vlejë deri më 31.12.2020.

Për modifikimin e kësaj MpB palët duhet të vendosin para skadimit të afatit.


Në rast të mosmarrëveshjes/pakënaqësisë nga ndonjëra palë, MpB mund të ndërpritet para afatit të paraparë duke dhënë një njoftim me shkrim 1- muaj më parë.

VIII Mospajtimet


Të dy palët në çdo kohë do të respektojnë dhe nderojnë kodin e sjelljes të partnerit të tyre, me kujdes të veçantë në pozicionet e paraqitura më lartë.

Vushtrri, më 13.08.2019

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)



Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv



Komuna e Vushtrrisë
Xhafer Tahiri
Kryetar